

DHOMA E POSAÇME E  
GJYKATËS SUPREME TË  
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË  
LIDHEN ME AGJENCINË  
KOSOVARE TË  
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE  
SUPREME COURT OF KOSOVO  
ON KOSOVO TRUST AGENCY  
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA  
VRHOVNOG SUDA  
KOSOVA ZA PITANJA  
KOJA SE ODNOSE NA  
KOSOVSKU  
POVERENIČKU AGENCIJU

**ASC-09-0045**

Në padinë e

[REDACTED], Pejë

*Ankuesja*

përfaqësuar nga avokatja [REDACTED] nga Peja  
rr. [REDACTED]

kundër

**Agjencia Kosovare e Mirëbesimit**

*I Padituri*

përfaqësuar nga Zyra Ligjore e UNMIK-ut,  
Kompleksi TSS, Prishtinë

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetari i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 8 mars 2010, lëshon këtë

## A K T V E N D I M

**1) Ankesa refuzohet si e pabazë.**

**2) Propozimi për kthimin në gjendjen e mëparshme hedhet poshtë  
si i papranueshëm.**

**3) Aktvendimi i Trupit Gjykues së DHPGJS-së për lëndën SCEL-08-003-0102 i datës 9 korrik 2009 vërtetohet.**

**Gjendja procedurale:**

Trupi Gjykues i DHPGJS-së më 9 korrik 2009 lëshoi një aktvendim për lëndën SCEL-08-003-0102 duke refuzuar ankesën e Ankueses si të papranueshme në pajtim me Nenin 10.6 (a) të RREG së UNMIK-ut 2003/3. Trupi Gjykues theksoi se Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) ka publikuar listën e punëtorëve të cilët vlerësohet se kualifikohen për marrjen e një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH Metohija/Rugova në Pejë dhe se afati për parashtrimin e ankesave për listën e lartpërmendur ka përfunduar më 2 qershor 2008. Më tej Trupi Gjykues theksoi se Ankuesja parashtrroi ankesën e saj pranë DHPGJS-së më 6 maj 2009 dhe si e tillë pas mbarimit të afatit për parashtrimin e ankesave.

Më 12 gusht 2009 Ankuesja parashtrroi një ankesë kundër aktvendimit të përmendur duke i kërkuar Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së të prishë aktvendimin dhe të miratojë ankesën e saj kundër listës si e parashtruar me kohë dhe e bazuar. Në përgjigjen ndaj urdhrit të Kolegjit të Ankesave të datës 18 dhjetor 2009, Ankuesja theksoi se ajo ishte e përfshirë në listën e parë të punëtorëve me të drejta legjitime, por jo edhe në listën e re të hartuar. Në kohën e parashtrimit të ankesave kundër listës së re të hartuar ajo kishte qenë në gjendje të rëndë shëndetësore dhe ishte hospitalizuar.

**Arsyetimi Ligjor:**

*Dështimi për ta parashtruar ankesën brenda afatit të paraparë*

Ankesa është e pranueshme por e pabazuar.

Sic ka theksuar edhe Trupi Gjykues i DHPGJS-së në pajtim me Nenin 10.6 (a) të Rregullores (RREG) së UNMIK-ut 2003/3 pas paraqitjes së kërkesës nga individi apo individët me të drejtë të cenuar, ankesa lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, e përcaktuar nga Agjencia i nënshtrohet shqyrimit nga DHPGJS-ja dhe se ankesa duhet të parashtrohet pranë DHPGJS-së brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare të listës së të punësuarve me të drejta legjitime nga Agjencia në media. AKM-ja shpalli listën e të punësuarve me të drejta legjitime të NSH "Rugova" në Pejë më 7, 8, 10, 11 maj 2008. Andaj duke llogaritur nga data e shpalljes përfundimtare të listës, afati për parashtrimin e ankesës ka përfunduar më 2 qershor 2008. Ankuesi ka parashtruar ankesën pranë DHPGJS-së më 6 maj 2009 dhe rrjedhimisht pas mbarimit të afatit për parashtrimin e ankesave. Këto fakte nuk kontestohen dhe përfundimi i Trupit Gjykues të DHPGJS-së është i drejtë.

#### *Propozimi për kthimin në gjendjen e mëparshme*

Ankesa gjithashtu interpretohet si propozim për rikthimin në gjendjen e mëparshme, por si e tillë hedhet poshtë pasi që është parashtruar pas afatit.

Ankuesja në ankesën e saj kishte nënvizuar se në kohën kur ankesa duhet të ketë qenë parashtruar kundër listës së shpallur ajo ishte në gjendje të rëndë shëndetësore dhe se ishte hospitalizuar. Si dëshmi për ti mbështetur këto deklarata, Ankuesja ka paraqitur dokumente që vërtetojnë se ajo ishte trajtuar në Spitalin Rajonal të Pejës prej 4 deri më 14 prill 2008 dhe prej 25 deri më 28 maj 2009 dhe më pas në Klinikën Akademike Ushtarake në Beograd më 29 maj 2009.

Sipas Nenit 117 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK) (Gazeta Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596) nëse palë nuk arrin të ndërmerr ndonjë veprim në procedurë brenda afatit të paraparë dhe për këtë shkak humb të drejtën ta ndërmarr atë veprim, gjykata do t'i lejoj kësaj pale, me

propozimin e saj, ta kryej më vonë këtë veprim po që se e çmon se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për një ometim të tillë. Përveç kësaj Neni 118 i LPK-së parashikon se propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme i paraqitet gjykatës, pranë së cilës është dashur të kryej veprimi i ometuar dhe se propozimi duhet të paraqitet brenda pesëmbëdhjetë ditësh, duke llogaritur që nga dita kur ka pushuar arsyja që ka shkaktuar ometimin. Pasi të kenë kaluar tre muaj nga dita e ometimit, nuk mund të kërcohët kthimi në gjendje të mëparshme.

Afati për parashtrimin e ankesave kundër listës së shpallur nga AKM-ja ka përfunduar më 2 qershori 2008. Propozimi për kthimin në gjendjen e mëparshme është dashur të parashtronet pranë DHPGJS-së më së voni më 3 shtator 2008. Për arsyen se afati për parashtrimin e propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme ka kaluar, kthimi nuk lejohet më dhe propozimi i Ankueses hedhet poshtë si i papranueshëm.

#### *Procedura Gojore për Ankesa*

Bazuar në Nenin 63.2 të Urdhëresës Administrative (UA) të UNMIK-ut 2008/6 Kolegji i Ankesave vendosi ta refuzojë pjesën gojore të procedurës.

Ankuesja ka kërkuar një seancë gojore në mënyrë që "të përballet me të Paditurin" dhe të paraqesë dëshmi mbi atë se ajo i plotëson kushtet që të përfshihet në listën e punëtorëve me të drejta legitime. Ankesa e Ankueses është parashtruar pas kalimit të afatit dhe se kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet më. Prandaj dëshmitë që do të paraqiteshin në seancën gojore nuk kanë rëndësi ligjore për përfundimin e lëndës.

Për këto arsyе vendoset si në dispozitiv.

Richard Winkelhofer,  
Gjyqtari Kryesues i EULEX-it

nënshtkruar

Torsten Koschinka,  
Gjyqtar i EULEX-it

nënshkruar

Eija-Liisa Helin,  
Gjyqtare e EULEX-it

nënshkruar

Tobias Lapke,  
Regjistrues i EULEX-it

nënshkruar